



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/S5-10 Prot.
Nr. Dok. 202502558/10

Tiranë 15/07/2025

Lënda: *Rekomandim për bashkërendimin e punës, në mënyrë që t'i mundësohet shtetasit të huaj S. R. Sh., paraqitja e kërkesës për azil.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE
Tiranë

DREJTORISË VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Tiranë

Për dijeni: **Ministrisë së Drejtësisë**
Tiranë

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit
Tiranë

Të nderuar,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë përfaqësuesi ligjor i shtetasit S. R. Sh., lindur në _____, Bangladesh, i cili ka hyrë në territorin e Shqipërisë në datën 01.02.2025, dhe është arrestuar nga policia e Aeroportit "Rinas", si person i kërkuar nga autoritet e Bangladeshit, i akuzuar për kryerjen e një vepre penale, për të cilën parashikohet dënimi me vdekje. Aktualisht ky shtetas ndodhet në IEVP "Mine Peza", Tiranë, në pritje të procedurës së ekstradimit.

Më konkretisht, përfaqësuesi ligjor pretendon se shtetasi S. R. Sh. ka paraqitur kërkesë për azil, në mënyrë verbale, në momentin e arrestimit, si dhe në procesverbalin e marrjes në pyetje, por kjo kërkesë nuk është regjistruar dhe referuar pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

Ndërkohë, përfaqësuesi ligjor i shtetasit S. R. Sh., ka paraqitur kërkesë me shkrim për azil për këtë shtetas, pranë Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë.

Kjo Drejtori i ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. K-1265/1 Prot., datë 11.03.2025, ku ka refuzuar regjistrimin e kërkesës për azil, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“Bazuar në Ligjin nr. 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 26, pika 1 “Regjistrimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare”, përcaktohet se:

“Shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi mund të shprehë qëllimin për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, verbalisht ose në formë të shkruar, në momentin e hyrjes në territorin e Republikën e Shqipërisë, në një pikë të kalimit kufitar, në një stacion të Policisë së Shtetit, pranë autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin”.

Referuar pikës 7 të këtij neni, përcaktohet se procedura e nevojshme pas momentit të paraqitjes së kërkesës, që ka të bëjë me marrjen e gjurmëve daktiloskopike, fotografisë dhe dëshmive të tjera në lidhje me kërkesën, fakt që shprehimisht lidhin praktikën e kërkuarit (shtetasit të huaj) para apo pranë autoritetit përgjegjës për Kufirin dhe Migracionin.

*Shtetasi i huaj S. R. **nuk është paraqitur fizikisht** pranë Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë apo të kemi dijeni se mund ta ketë shprehur këtë kërkesë në ndonjë stacion tjetër Policie”.*

Në këto kushte si dhe bazuar në nenin 25, pika 1, të Ligjit nr. 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet detyrimi i autoriteteve përgjegjësë, për t’i mundësuar shtetasit të huaj, paraqitjen e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, edhe kur ai mbahet në një institucion të ekzekutimit të vendimit penal, me shkresën Nr. K2/S5-2 Prot., datë 28.03.2025¹, iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Mine Peza, për të na informuar mbi mundësinë e shoqërimit të shtetasit S. R. Sh., për te Drejtoria Vendore për Kufirin dhe

¹ Kjo shkresë i është dërguar për dijeni Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë dhe përfaqësuesit ligjor të shtetasit S. R. Sh.

Migracionin, Tiranë, për të paraqitur kërkesë për azil dhe bashkërenditjen e punës ndërmjet institucioneve për realizimin e kësaj të drejte.

IEVP Mine Peza, na ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 1480/1 Prot., datë 02.04.2025, ku thuhet se, IEVP-ja kryhen shoqërimin e të burgosurit jashtë institucionit, me iniciativën e saj, vetëm për arsye shëndetësore, për rastet e dhënies së lejeve të veçanta apo shpërblyese, për në gjendjen civile dhe për të burgosurin e punësuar.

Gjithashtu, IEVP Mine Peza sqaron se, në të gjitha rastet e tjera, shoqërimi i të burgosurit jashtë institucionit, kryhet në kuadër të urdhrave apo kërkesave të organeve të tjera ligjzbatuese dhe të gjitha lëvizjet kryhen nga Forca Operacionale të Policisë së Burgjeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Ndërsa, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve na ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 6259/1 Prot., datë 26.06.2025, ku shprehet se shoqërimi i këtij shtetasi është i pamundur, pasi një gjë e tillë nuk është e parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe bazuar në Ligjin nr. 10/2021 “*Për Azilin në Republikën e Shqipërisë*”, është kompetencë e Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, për marrjen e masave për plotësimin e dokumentacionit sipas kërkesave të parashikuara në aktet ligjore.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve shpreh gatishmërinë për pritjen dhe orientimin e strukturave të policisë së shtetit me qëllim kryerjen e procedurave përkatëse me shtetasin S. R. Sh.

Vlerësimi i Institucionit të Aokatit të Popullit

Në nenin 25, pika 1, të Ligjit nr. 10/2021 “*Për Azilin në Republikën e Shqipërisë*”², parashikohet detyrimi i autoriteteve përgjegjese, për t’i mundësuar shtetasit të huaj, paraqitjen e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

² Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën e Këshillit 2001/55/KE, datë 20 korrik 2001, “Mbi standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rastet e flukseve masive të personave të shpërngulur dhe mbi masat që promovojnë një ekuilibër përpjekjesh ndërmjet Shteteve Anëtare në pritjen e këtyre personave dhe përballimin e pasojave”. Numri CELEX 32001L0055, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 212, datë 7.8.2001, f. 12–23.

- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003 “Mbi të drejtën e bashkimit familjar”. Numri CELEX 32003L0086, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 251, datë 3.10.2003, f. 12–18.

- Direktivën 2011/95/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 dhjetor 2011 “Mbi standardet për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët ose për personat që kanë të drejtë për mbrojtje plotësuese, dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë”. Numri CELEX 32011L0095, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L nr. 337, date 20.12.2011, f. 9–26.

Më konkretisht, në nenin 25, pika 1, përcaktohet se:

*“1. Kur ka të dhëna se shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, që mbahen **në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale** ose paraqiten në pikat e kalimit kufitar, duke përfshirë zonat e tranzitit në kufijtë e Republikës së Shqipërisë, mund të paraqesin kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare, **autoritetet përgjegjëse u sigurojnë atyre informacion për mundësinë për ta bërë këtë kërkesë.** Në vendet e cituara në këtë pikë dhe në pikat e kalimit kufitar, organi kompetent shtetëror duhet të mundësojë përkthimin, sipas nevojës, për ta lehtësuar mundësinë e aksesit në procedurat për përcaktimin e statusit të mbrojtjes”.*

Kjo garanci e ligjit tonë, për t’i mundësuar shtetasit të huaj, paraqitjen e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, edhe në kushtet e privimit të lirisë, është në përputhje me Direktivën 2013/32/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013, “*Mbi procedurat e zakonshme për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare*”, pika 28 (fq. 62) dhe neni 8, pika 1 (fq. 68).

Në rastin konkret, shtetasi i huaj S. R. Sh., mbahet në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale dhe është detyrë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Tiranë, që të bashkërendojnë punën për t’i mundësuar atij të paraqesë kërkesën për azil, pavarësisht vendimmarrjes së autoritetit përgjegjës për pranimin apo refuzimin e kësaj kërkesë.

Procedura e regjistrimit të kërkesës për azil, përfshin marrjen e gjurmëve daktiloskopike, e fotografisë, dëshmime të tjera në lidhje me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare dhe hedhjen e të dhënave në regjistrin elektronik (neni 26, pika 7 e Ligjit nr. 10/2021).

Kjo procedurë e bën të detyrueshëm praninë e shtetasit të huaj në zyrat e autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin dhe rrjedhimisht marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për shoqërimin të tij, kur ai është i burgosur.

Legjislacioni për të drejtat e të burgosurve nuk e kufizon shoqërimin e të burgosurve jashtë IEVP-së, vetëm në disa raste të veçanta. Përkundrazi,

- Direktivën 2013/32/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013, “Mbi procedurat e zakonshme për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare”. Numri CELEX 32013L0032, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 80, datë 29.6.2013, f. 60–95.

- Direktivën 2013/33/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013, “Për përcaktimin e standardeve për pranimin e kërkuarve për mbrojtje ndërkombëtare”. Numri CELEX 32013L0033, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 180, datë 29.6.2013, f. 96–116.

legjislacioni ka hapësirat e nevojshme për garantimin e të drejtave të shtetasve të huaj, të burgosur.

Më konkretisht:

Në nenin 5, pika 7 e Ligjit Nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, parashikohet se: *“Të burgosurit shtetas të huaj ose persona pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike me të cilat këta persona përballen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale gjatë transferimit dhe pas lirimit”*.

Për sa i përket shoqërimit jashtë IEVP-së, në nenin 57, pika 1, e Ligjit Nr.81/2020, parashikohet se: *“Lëvizjet e burgosurit jashtë institucionit bëhen për aq sa është e mundur brenda një kohë sa më të shkurtër dhe në çdo rast nën shoqërimin e personelit të Policisë së Burgjeve, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve”*.

Ndërsa, në nenin 20, pika 1, shkronja “ll”, të VKM Nr.209, datë 06.04.2022 *“Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”*, parashikohet se: *“Gjatë qëndrimit në institucion, të burgosurit, me përjashtim kur parashikohet ndryshe për kategori të veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë të drejtat, si më poshtë vijon:*

...

çdo e drejtë tjetër e parashikuar në legjislacionin në fuqi”.

Po ashtu, në paragrafin me titull “Politika”, të Urdhrit Nr.651, datë 21.01.2019 e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve *“Transportimi dhe shoqërimi i të Burgosurve”*, thuhet se: *“Drejtoria e Policisë së Burgjeve, merr masat e sigurisë, gjatë shoqërimit jashtë perimetrit të sigurisë, për arsye të pjesëmarrjes në proceset gjyqësore, vizita mjekësore dhe **qëllime të tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore**, duke garantuar të drejtat e të dënuarve dhe të paraburgosurve dhe sigurinë publike”*.

Një nga të drejtat e shtetasit të huaj është ajo për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në rastet kur shtetasi i huaj ndodhet i burgosur, kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet, nëse ai nuk shoqërohet te zyrat e autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin, në mënyrë që kërkesa e

tij të regjistrohet sipas procedurës administrative të parashikuar në Ligjin nr. 10/2021 *“Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”*.

Kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare janë shumë sensitive, dhe koha e regjistrimit të tyre është e rëndësishme, pasi e drejta nuk realizohet dot në ndonjë moment të dytë.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

REKOMANDOJMË:

- Bashkërendimin e punës midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, në mënyrë që t'i mundësohet shtetasit të huaj S. R. Sh., paraqitja e kërkesës për azil pranë organit kompetent.
- Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, për të garantuar të drejtat themelore të njohura nga Kushtetuta, për të huajt në Republikën e Shqipërisë.
- Përgjithësimin e rastit për të zbatuar në mënyrë korrekte të drejtat e shtetasve të huaj, në lidhje me garantimin e mbrojtjes ndërkombëtare.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V